



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENË DANA:		13.07.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJÇA PRILOG
05-	453/01-	31961	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Rithirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e aktiviteteve të OJQ-ve të regjistruara.

1. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për aktivitete të organizimit “ Rinia Fest-Lipjan 2026 ” në Komunën e Lipjanit.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt në lëmin e rinisë dhe kulturës përmes objektivave e aktiviteteve rinore dhe kulturore, që janë të shumëllojshme.

Sipas Objektivave :

- 2.1. Fuqizimi i rinisë
- 2.2. Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse aktive
- 2.3. Aktivitete rekreative
- 2.4. Mbrëmje rinore

3. Përfutuesi do të kujdeset për: Ofrimin e aktiviteteve me të cilin do të përmbushen të gjitha objektivat e thirrjes publike (detajet tjera rreth kësaj thirrje do të i gjeni në udhëzuesin i cili do të publikohet në web faqe, së bashku me formularët e aplikimit)

4. Vlera totale e mbështetjes sipas thirrjes është 3,000.00 euro (tremijë euro).
Minimale 501.00€ deri në 3,000.00€.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **7 ditë pune** dhe përfundon me datën **21.07.2026**.
Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe rekreacion. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Lipjanit, Rruga „Shqipëria” Zyra për shërbim të qytetarëve, nr 3, Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net

Lipjan, 13.07.2026

Astrit Buja
Drejtor për Kulturë, Rinë dhe Sport

